

NJOFTIM PËR HAPJEN E KONKURRIMIT PUBLIK

Mbështetur në nenin 4 të Rregullores “Për përdorimin e fondit të prodhimit të pavarur”, të miratuar me Vendimin nr. 66, datë 07.11.2016 të Këshillit Drejtues të RTSH, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH shpall publikisht hapjen e konkurrimit publik për mbledhjen e projekteve nga subjektet e interesuara:

Objekti:	Financim i prodhimit të programeve të pavarura të transmetimit audioviziv
Forma e prodhimit:	Prodhim i porositur
Lloji i prodhimit të pavarur:	Prodhim filmik Serial televiziv
Numri i serive televizive:	10 (dhjetë)
Kohëzgjatja e një serie televizive:	40 (dyzetë) minuta – 45 (dyzetëpesë) minuta
Fondi financiar:	10,000,000.00 (dhjetëmilionë) lekë
Natyra e Serialit televiziv:	Serial televiziv komiko - social, që prek problematikat në Shqipëri, trajtuar me nota humori.
Grup – mosha:	për të gjitha moshat
Vendi i prodhimit:	Republika e Shqipërisë
Gjuha:	Gjuha shqipe
Afatet e prodhimit:	90 (nëntëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës me RTSH
Periudha e transmetimit:	Transmetimi i parë i serisë televizive të parë: muaji Prill 2021
Formati i prodhimit:	16:9, Full HD, 4K, Sony – f55 – cinelata – 4K
Audio:	Stereo
Ngjyrat:	Me ngjyra
Të drejtat:	RTSH zotëron të gjitha të drejtat e shfrytëzimit të secilës prej 10 (dhjetë) serive televizive të Serialit televiziv
Forma e të drejtave:	Ekskluzive
Kohëzgjatja e të drejtave:	E pakufizuar
Territori:	Republika e Shqipërisë si dhe territoret e të gjithë shteteve të Botës
Numri i transmetimeve:	I pakufizuar

Personi fizik ose juridik i interesuar, duhet të paraqesë kërkesën pranë Sektorit të Projekteve dhe të Administrimit të të Drejtave në RTSH brenda datës 05 Shkurt 2021, deri në orën 12:00, e cila duhet të përmbajë detyrime:

1. Përshkrimi narrativ i projektit, qëllimi dhe objektivat e projektit, anët pozitive dhe anët negative të projektit, projekt – preventivi financiar i buxhetit të projektit i detajuar në zëra të veçantë;
2. Skenari/Sinopsi i projektit;
3. Staf i parashikuar për realizimin e projektit;
4. Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit ose Ekstrakti Historik i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit, i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), të mos jetë më i vjetër se 10 (dhjetë) ditë, nga data e paraqitjes së kërkesës në Sektorin e Projekteve;
5. Çertifikata e regjistrimit e personit të tatueshëm për personin fizik të interesuar ose për personin juridik të interesuar, të mos jetë më i vjetër se 10 (dhjetë) ditë, nga data e paraqitjes së kërkesës në Sektorin e Projekteve;
6. Dokumenti i lëshuar nga Administrata Tatimore e Shqipërisë, përmes të cilës vërtetohet se personi fizik i interesuar ose personi juridik i interesuar nuk ka detyrime tatimore të papaguara. Dokumenti të mos jetë më i vjetër se 10 (dhjetë) ditë, nga data e paraqitjes së kërkesës në Sektorin e Projekteve;
7. Dokumenti i lëshuar nga Administrata Tatimore e Shqipërisë, përmes të cilës vërtetohet se personi fizik i interesuar

ose personi juridik i interesuar nuk ka detyrime për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara. Dokumenti të mos jetë më i vjetër se 10 (dhjetë) ditë, nga data e paraqitjes së kërkesës në Sektorin e Projekteve;

8. Leja e Produksionit e personit fizik të interesuar ose e personit juridik të interesuar, e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë së Shqipërisë, e cila duhet të jetë e vlefshme;
9. Vërtetim i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, përmes të cilës vërtetohet se për personin fizik të interesuar ose për personin juridik të interesuar, sipas regjistrave të gjykatës nuk rrezulton që të ketë proces gjyqësor civil me RTSH;
10. Vërtetim i lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, që personi fizik i interesuar ose personi juridik i interesuar nuk ka procedim penal të regjistruar në ngarkim të tij;
11. Deklaratë noteriale përmes të cilës personi fizik i interesuar ose personi juridik i interesuar merr përsipër të gjitha detyrimet në lidhje me të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të për përdorimin e veprave në projekt;
12. CV e personit fizik të interesuar ose e personit juridik të interesuar;
13. Vendi i realizimit të projektit;
14. Deklaratë e personit fizik ose juridik që:
 - (i) personat pjesëmarrës në program, apo të përfshirë në në përgatitjen e tij dhe pajisjet e mjetet për realizimin e programit vendosen nga vetë personi fizik ose juridik;
 - (ii) nuk është një transmetues audioviziv, pjesë e tij, apo aksionar në një transmetues;

Personi fizik ose juridik i interesuar, përveç dokumentacionit të kërkuar si më sipër, duhet të plotësojë formularin që përmban informacionin e domosdoshëm mbi projektin dhe subjektin aplikues.

Formulari mund të tërhiqet pranë Sektorit të Projekteve dhe të Administrimit të të Drejtave në RTSH çdo ditë, nga ora 10:00 deri në orën 15:00.

DREJTORI I PËRGJITSHËM I RTSH

Thoma GËLLÇI